

C.nr.262/2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike të paditëses [REDAKTUAR], nga Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati [REDAKTUAR] nga Ferizaj kundër të paditurit [REDAKTUAR], nga Ferizaj, baza juridike shpërblimi i dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë më date 21.02.2017, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkespadija e paditëses [REDAKTUAR], me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri [REDAKTUAR], nga Ferizaj që paditëses në emër të shpërblimit të dëmit t'ia paguaj edhe atë: në emër të dëmit material dëmtimi 18 copa fidane në vlerë prej 100.00, mbjedhja përpunimi i vendit të dëmtuar 100.00, dëmtimi i disa rrënjeve me dredhëza në vlerë prej 50.00, shpenzimet e procedurë penale, pjesëmarrja në tri seanca 30.00, në emër të dëmit jomaterial: për frikë të pësuar personalisht dhe fëmijët e sajë të mitur 300.00, për shkaktimin e vuajtjeve shpirtërore të anëtarët e familjes 300.00, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 880.00 euro [tetëqindëtetëdhjetë euro], me kamatë prej 8 % , nga dita e paraqitjes së padisë date 29.04.2015 deri në pagesën përfundimtare .

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

III. Detyrohet paditësja [REDAKTUAR] që kësaj gjykate në emër të takses për aktgjykim t'ia paguaj shumën e të hollave prej 15 euro.

A r s y e t i m

Paditësja [REDAKTUAR], në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditurit [REDAKTUAR] me bazë juridike kompensimi i dëmit material dhe jo material.

Pala paditëse në padi ka theksuar: Me aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik, ka shpallur fajtorë dhe ka gjykuar të paditurin për shkak të veprës penale kanosje dhe dëmtim i pasurisë së luajtshme. Me qenëse në dispozitivin e aktgjykimin gjykata nuk ka vendosur për dëmin që i është shkaktuar paditësit, por ajo udhëzohet që kërkesën e vet ta paraqes në kontest civil. I padituri palës paditëse i ka shkaktuar dëm material më datë 09.05.2011 duke i prerë 18 copë trupa fidanesh si dhe një shumë të konsiderueshme të dredhëzave. Shpërblimi i dëmit material konsiston në: dëmtimi i 18 copa fidane në vlerë prej 100.00 euro, mbjellja dhe përpunimi i vendit të dëmtuar 100.00 , dëmtimi i disa rrënjeve me dredhëza në vlerë prej 50.00 euro, shpenzimet e procedurës penale pjesëmarrja në tri seanca 30.00 euro. Shpërblimi i dëmit jo material konsiston në: për frikë të pësuar personalisht dhe fëmijët e mi të mitur 300.00 euro, për shkaktimin e vuajtjeve shpirtërore të anëtarët e familjes prej 300.00 euro.

Përfaqësuesi i paditëses [REDAKTUAR] gjatë seancës ka theksuar se kërkon të aprovohet si e bazuar kërkesëpafia e paditëses me përmbajtje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket parashkrimit i njejtë ka theksuar se nuk është arritur ,sepse paditësja në lëndën penale ka parashktruar kërkesë pasurore juridike.

I padituri ka theksuar: I padituri e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi dhe i propozon gjykatës që të njëjtën ta hudhë si ligjërisht të pabazuar. Paditësja me datë 29.04.2015 në gjykatë ka parashtruar padi të paafatshme për kompensim të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar më datë 09.05.2011. Neni 357 par. 1 i Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore , thotë, e citoj :”Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.” Pra kërkesa e paditëses është parashkruar, pasi prej datës 09.05.2011 kur është shkaktuar dëmi e deri më datë 29.04.2015 kur është parashtruar pafia kanë kaluar 3 vjet e 11 muaj e 20 ditë. Dmth, kanë kaluar 11 muaj e 20 ditë nga afati 3 vjeçar i të drejtës për të parashtruar kërkesë të tillë. Neni 358 par .1 i po të njejtit ligj thotë, citoj: “Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”. Pra kërkesa e paditëses është parashkruar pasi ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, gjegjësisht ndaj tani të paditurit. Kërkesa e paditëses nuk mund të parashtrohet edhe poqëse i referohemi dispozitave të nenit 361 par.1 të këtij ligji ku thuhet, citoj “ Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent parashkruhen për dhjetë vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim” me që Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë P.nr.153/2013 i datës 21.04.2015 nuk e ka marrë formën e prerë me obligimet që dalin prej tij, nga se i njejtë me aktgjykimin e shkallës së dytë AP1.NR.705/2015 të datës 27.07.2015 është ndyshuar e me të cilin është aprovuar ankesa e të akuzuarit si e bazuar dhe është refuzuar aktakuza kundër tij për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Ndaj këtij aktgjykimi nuk është kërkuar revizion dhe si i tillë është bërë i plotëfuqishëm. Aktgjykimi i plotëfuqishëm i shkallës së dytë, aktgjykimin e shkallës së parë P.nr.153/2013 të datës 21.04.2015 e ka bërë ligjërisht të pazbatueshëm, prandaj edhe nuk mundet më të procedohet sipas tij, qka do të thotë se pushojnë të gjitha obligimet që dalin prej tij, ndërsa vlejnë vetëm obligimet që dalin nga aktgjykimi i shkallës së dytë. Aktgjykimi i shkallës së dytë të akuzuarin, tani të paditurin, nuk e ka ngarkuar me asnjë lloj obligimi, andaj edhe nuk mundet të parashtrohet kurrëfar kërkesë ndaj tij sipas aktgjykimit të shkallës së parë. Për më tepër, paditësja nuk ka mundur të parashtron kërkesë pasurore juridike edhe për arsyen se i padituri as edhe një veprim të vetin nuk e ka kryer në pronën e saj nk.nr.178-5 dhe nuk i ka shkaktuar kurrëfarë dëmi asaj, por qdo veprim që e ka ndërmarrë, e ka ndërmarrë në pronën publike nk.nr.179-0 apo në pronën e DZHE-së në Komunën e Ferizajt, të cilën pronë publike paditësja e kishte uzurpuar dhe me uzurpimin për gjashtë (6) vite me radhë shkaktonte dhe ende po shkakton pengesa që unë ta posedoj pronën time nk.nr.178-6. Në procedurë administrative kjo pronë publike tani më është deuzurpuar nga

organi kompetent i Komunës së Ferizajt, dhe pas deuzurpimit atë pronë publike organi në fjalë e ka rrafshuar me bager duke shkukur qdo bimë në atë pronë, ndërsa e paditura edhe përkundër kësaj vazhdon me pengesat ndaj meje. I padituri po ashtu i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar kërkespadija e paditëses si e pabazuar .

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe sa më të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo-juridike gjatë shqyrtimit gjyqësorë janë administruarë si provë: aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj dega në Kaqanik P.nr.153/2013, deklarata e datës 25.01.2011, procesverbali nga vendi i ngjarjes P.nr.153.2011, procesverbali i datës 10.04.2015 P.nr. 153/2013, procesverbali i datës 10.04.2015 tjetër, procesverbali tjetër i datës 10.04.2015, procesverbali i datës 21.04.2015 P.nr 153/13, aktvendimi C.nr. 318/11 i datës 05.10.2015, katër(4) shkresa të lëshuara nga Raiffeisen Bankë, skica e identifikimit të datës 07.09.2015, ankesa e dorëzuar në gjykatë e datës 08.05.2015 që ka lidhje me lëndën P.nr.153/13, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë i datës 27.07.2015 PA1.nr.705/2015, si dhe është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarës [REDACTED]

Gjykata pasi analizoi provat e administruara ,thënjet e palëve ndërgjyqëse vendosi ashtu siq është shkruar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye :nga thënjet e paditëses në padi gjykata ka vlerësuar ,se paditësja nga i padituri kërkon kompenzimin e dëmit ,i cili sipas paditëses është shkaktuar në datat 09.05.2011 dhe 12.05.2011, dhe paditësja ka theksuar se ajo ka mësuar për dëmin në fjalë në datat e sipër përmendura ,nga procesverbali nr.P.nr.153/13 ,i datës 21.04.2015 rezulton se paditësja në procedurë penale ka parashtruar kërkesë pasurore juridike për kompenzimin e dëmit me datë 21.04.2015 ,kurse nga vula e pranimi të padis e cila është objekt shqyrtimi ,sipas kësaj lënde ,rezulton se paditësja padin në fjalë për kompenzimin e dëmit e ka paraqitur në gjykatë me datë 29.04.2015 ,pra nga gjendja faktike e sipër përmendur rezulton se paditësja kërkesën e sipër për kompenzimin e dëmit ,si dhe padin e sipër përmendur ,me të cilat ka kërkuar kompenzimin e dëmit ,i ka paraqitur në gjykatë pas kalimit të afatit 3 vjeçar ,kjo edhe për shkak se edhe nga data 09.05.2011 ,deri me datën 09.05.2014 bëjnë tri vite ,si dhe nga data 12.05.2011 deri me datën 12.05.2014 bëjnë tri vite,kurse paditësja kërkesën pasurore juridike e ka parashtruar në procedurës penale me datë 21.04.2015 ,ndërsa padin në këtë gjykatë 29.04.2015 ,ndërsa nga ajo që u theksua më lartë rezulton se parashkrimi kërkespadijs së paditëses ka ndollur qysh në Maj të vitit 2014.Meqë ka kaluar afati i sipër përmendur 3 vjeçar ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesëpadijs së paditëses edhe atë në bazë të nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së vitit 1978,dhe nenit 357 paragrafi 1 të LMD-së së Kosovës.Sa i përket kërkesës për shpenzimet në procedurë penale ,pjesëmarrja në tri seanca 30.00,gjykata konsideron se e njejta është e pabazuar ,ngase procedura penale kundër të paditurit ka përfundur me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PA1.nr.705/2015, me të njejtin akuza ndaj të paditurit ishte refuzuar dhe nga kjo arsye i padituri nuk mund të ngarkohet me shpenzimet e një procedure e cila përfunduar në mënyrën siq u theksua si më lartë,përveq kësaj gjykata në procedurë civile kontestimore vendos për shpenzimet që kan lidhje me procedurën e zhvilluar kontestimore,kurse pala nëse ka ndonjë kërkesë sa i përket procedurës penale ka mundur të njejtën ta parashtrroj në procedurë penale.

Gjykata ka analizuar edhe aktgjykimin penal P.nr.153/2013 ,të datës 21.04.2015 mirëpo sipas qëndrimit të kësaj gjykate i njejt i aktgjykim nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje civilo juridike sepse kërkespadi e paditëses është parashkruar dhe i njejt i aktgjykim nuk mund prodhoj pasoja juridike për të paditurin,sepse është ndryshuar me aktgjykimi e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PA1.nr.705/2015, me të njejtin akuza ndaj të paditurit ishte refuzuar.Ky qëndrim i gjykatës bazohet edhe në faktin se sipas nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ,çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin. Kurse me nenin 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ishte paraparë se çdo person i dyshuar ose që akuzohet se ka kryer vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë. Kurse me nenin 3 të Kodit Penal të Kosovës është paraparë paraparë se Çdo person i dyshuar ose që akuzohet se ka kryer vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë ,mirëpo kjo gjykatë konsideron se të njejtat prova nuk mund të kenë ndikim në vendosjen sipas kësaj qështje sepse kërkesëpadi e paditëses është parashkruar.


Gjykata ka vlerësuar thënjet e përfaqsesit të paditëses kur ka theksuar se parashkrimi nuk është arritur ,sepse paditësja në lendën penale ka parashkruar kërkesë pasurore juridike,mirëpo kjo gjykatë këto thënje i quan të pabazuar,sepse kërkespadi e paditëses qysh në Maj të vitit 2014 ka qenë e parashkruar dhe se parashtrimi i kërkesës pasurore juridike nuk ka mundur të ketë ndikim në parashkrimin e kërkesës ,sepse kërkesa në fjalë është parashtruar pasi ka ndollur parashkrimi edhe atë me date 21.04.2015,kurse kërkesa e e paditëses është parashkruar në Maj të vitit 2014

Gjykata e ka detyruar paditësen që kësaj gjykate t'ia paguaj taksën gjyqësore për aktgjykimi,duke u bazuar në udhëzimin administrativ për Unifikimin e taksave gjyqësore.

Gjykata ka vendosur që secila pale ti bartë shpenzimet e veta të procedures kontestimore ,sepse paditësja e ka humbur kontestin gjyqësorë ,kurse i padituri në mënyrë të specifikuar nuk ka treguar shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim ashtu siq parashihet me dispozitën e nenit 463 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë 21.02.2017



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga data e pranimin të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO SNAŽNA
GJYKATA THEMELORE OSNOVNI SUD
FERIZAJ II URDEŠEVAC

Më
Dana

04.04.2017
20 17